

FJALA E DEPUTETES MILVA EKONOMI

E ENJTE 28 PRILL 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, dua ta nis fjalimin tim duke ju kujtuar se Bashkimi Europian në strategjinë e tij të zgjerimit për vendet që aspirojnë të bëhen pjesë e Bashkimit Europian ka vënë një listë me standarde për t'u përmbushur, që ndahen në 6 principe kryesore dhe monitorohen nga SIGMA. Ato kanë të bëjnë me fuqinë e ligjit, me demokracinë dhe funksionimin e mirë të administratës publike. Për fat të mirë, këtë vit, kur u botua vrojtimi që ato kishin bërë nga viti 2017 deri më tani, Shqipëria rezultoi si një nga vendet më të avancuara të Ballkanit, ajo kishte arritur të realizonte shumë nga treguesit, ku në 4 fusha ishte një nga vendet që kishte pasur një rritje të befasishme dhe në 5 fusha ishte më e mira në rajon. Kjo për qeverinë socialiste tregon se kryefjalë ka qeverisjen e mirë.

Qeverisje e mirë do të thotë që, përveçse duhet të bëjmë shumë kujdes në gjërat që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit, duhet të bëjmë shumë kujdes edhe në mënyrën se si hartojmë e konceptojmë ligjet. Gjithashtu, është e nevojshme që në këtë proces të përfshijmë edhe qytetarët tanë, por qytetarët nuk mund të përfshihen në qoftë se nuk informohen. Përveç gjërave që kemi realizuar në Kushtetutë apo ligjeve të miratuara nga ky Kuvend, në tërësinë e strukturës legjislative vjen edhe miratimi i kësaj konvente, që ka të bëjë me aksesin në dokumentet zyrtare. Kjo pa dyshim që u jep autoriteteve publike atë që është më thelbësore, transparencën, i lejon të gjithë qytetarët shqiptarë që të marrin informacion dhe të kuptojnë çdo proces që po ndodh në vendin tonë.

Në fakt, kjo konventë, e cila është hartuar që në vitin 2009, është ratifikuar nga 20 vende dhe Shqipëria bën pjesë në vendet e para që e ratifikojnë. Qëllimi është t'i japim në dorë qytetarit një armë më të sigurt, që të ndjekë dhe të marrë të gjithë informacionin që i duhet, për të kuptuar ngjarjet që ndodhin në vend dhe për të marrë edhe ai vendimet e tij të rëndësishme. Përveç kësaj, një element tjetër shumë i rëndësishëm në këtë konventë që duam të ratifikojmë sot, përveç transparencës, është edhe llogaridhënia, sepse çdo qytetar ka mundësi të aksesojë në dokumentet zyrtare, por edhe të kërkojë llogari për atë që ka ndodhur në administratën publike. Duke thënë këtë, dua të shtoj një informacion tjetër shumë të rëndësishëm: nga data 1 maj në vendin tonë nuk do të ketë më sportele fizike, por do të ketë vetëm sportele virtuale.

Kjo është një arritje shumë e madhe e administratës, është një nga ato betejat e filluara në krye të herës, për të mposhtur korrupsionin dhe për të treguar se për ne është shumë e rëndësishme që të funksionojmë në një mënyrë të integruar. Çfarë do të ndodhë me sportelet fizike që do të mbyllen më 1 maj? Ju kujtoj se ky proces ka nisur kohë më parë, kur ne filluam reformën e derrugllimit. Derregullimi kërkonte që e gjithë administrata publike duhej të bëhej gati, me procese të mirëmenduara, për të thjeshtuar dhe lehtësuar të gjithë procedurën e marrjes së një shërbimi nga një qytetar apo biznes. Mirëpo thjeshtimi i procedurës nuk ishte i mjaftueshëm, ai duhej të shoqërohej edhe me një suport digjital, të cilin e bëri të mundur AKSHI dhe platforma e-Albania.

Platforma e-Albania është një platformë shumë e lehtë, që mund ta përdorë nga kompjuteri, nga celulari apo nga një tablet çdokush që ka nevojë për të marrë një shërbim. Marrja e shërbimit në këtë formë nuk kërkon paraqitjen e dokumenteve zyrtare personalisht dhe fizikisht. Ndërkohë, për marrjen e këtij shërbimi kjo platformë ka nga pas një numër të madh punonjësish të administratës publike, që punojnë për këtë shërbim të kërkuar. Kjo do të thotë që në backoffice ne kemi vendosur administratorë civilë, të cilët janë të zotë të punojnë me regjistrat që këmbëjnë dokumente. Për të mundësuar këmbimin e dokumenteve gjatë këtyre viteve janë ndërtuar 55 regjistra thelbësorë të funksionimit të shtetit, të cilët ndërveprojnë me njëri-tjetrin nëpërmjet nënshkrimit elektronik.

Pra, në qoftë se një qytetar (qoftë ky në zonat rurale, qoftë në zonat urbane) kërkon një shërbim, ai vetëm aplikon për shërbimin dhe është e gjithë administrata publike ajo që merr përsipër plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për lëvrimin e këtij shërbimi. Kjo gjë do të bëhet nëpërmjet sistemit të qendëruar për nënshkrimit elektronik (SQDNE). Nuk është e lehtë të ngresh një proces të tillë nga hiçi! Gjërat që ka bërë Shqipëria deri më sot e kanë renditur atë në një nga vendet me performancën më të mirë digjitale, pasi për të arritur këtu duhet një infrastrukturë e mirëpërcaktuar informatike, e cila e ndihmon këtë gjë. Përveç kësaj, Shqipëria ka hartuar programe e software të posaçme për ta mundësuar këtë dhe, nga ana tjetër, ka trajnuar administratën për t'u përgjigjur për këtë ndryshim që po ndodh. Ju keni dëgjuar se sa shumë informacione shkëmbehen në njësinë e kohës dhe se si ne sot e kemi e vendosur sasinë e informacioneve që shkëmbejmë në njësi të matshme kohore.

Për shembull, që nga 1 janari i vitit 2020 në sistemin e nënshkrimit elektronik janë shkëmbyer rreth 110 mijë dokumente dhe kanë përfutur shërbime rreth 14,3 milionë aplikues. Shifrat janë vërtet shumë të larta, por ndërkohë çfarë kanë sjellë këto? Unë iu referova para pak kohësh një studimi që kishte bërë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Shqiptare e mbështetur nga IFC-ja (International Finance Corporation), në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, për të parë kohën e zhdoganimit

në pika të ndryshme kufitare. Ajo që të bënte më shumë përshtypje ishte koha e zhdoganimit, e cila ishte hartuar mbi një metodikë matjeje në pikat më të rëndësishme kufitare, nga ku hyjnë mallrat në Shqipëri. Koha e zhdoganimit, e lirimit të mallit për ta çuar në treg, në portin e Durrësit ishte shkurtuar gjatë vitit 2021 me 26%; koha e zhdoganimit në pikat doganore kufitare tokësore ishte shkurtuar me 20% dhe koha e zhdoganimit në pikat vendore doganore, që gjenden në Fier, në Elbasan dhe në Tiranë ishte shkurtuar me 74%.

Të gjitha këto janë bërë të mundura falë sistemit të komunikimit elektronik dhe falë shërbimeve online që ne kemi vendosur për të lehtësuar biznesin dhe qytetarin. Kështu që, unë besoj se ky revolucion digjital është pikërisht ai që i duhet Shqipërisë për të luftuar korrupsionin dhe për ta bërë shkëmbimin më të qenësishëm, të drejtpërdrejtë dhe të automatizueshëm, në një shoqëri ku vepron fuqia e ligjit, vepron demokracia dhe funksionon administrata publike. Pra, unë bëj një aplikim dhe dikush përgjigjet për këtë, është thjesht detyrë e administratës. Besoj të gjithë e kemi parë që në Europë aplikon një herë dhe i merr të gjitha shërbimet. Ka qenë një moto që i vë qytetarët në qendër dhe sot edhe Shqipëria me shumë sukses ia ka dalë.

Vlerësimet që ka marrë nga BERZH-i, nga SIGMA, nga Banka Botërore, nga RESPA, por edhe ato që mori nga Departamenti Amerikan i Shtetit janë shumë pozitive për të gjithë këtë revolucion digjital që ka bërë Shqipëria, për të mundësuar shërbime më të mira në kohë dhe më të lira për qytetarët. Të mos harrojmë se me gjithë këto shërbime digjitale që janë bërë, qytetarëve tanë u janë kursyer miliona euro. Shifrat përllogariten çdo ditë: janë kursyer miliona fletë A4, që printohen nga printerët e administratës dhe, gjithashtu, është kursyer kohë, sepse njerëzit nuk mbajnë më radhë. Radha e tyre është vetëm virtuale, për të përdorur një aplikacion që kanë në telefon, në kompjuter apo në tablet. Unë besoj se kjo konventë që po diskutojmë ne sot, që ka të bëjë me aksesin e dokumenteve zyrtare, vjen pikërisht në momentin e duhur, sepse fuqizon të gjithë këtë kuadër ligjor që ne kemi.

Shumë e rëndësishme në funksion të miratimit të konventës është se përdorimi i nënshkrimit elektronik, është një çelës më shumë për mbrojtjen e të dhënave personale. Nuk do të jetë vetëm kjo, janë edhe barrierat e sigurimit të të dhënave personale dhe të të gjitha të dhënave të regjistrave, që miratuar bashkërisht, pak kohë më parë në Kuvend, në kontratën me kompaninë John's, e cila siguron pikërisht këtë gjë. Ndaj, kolegë deputetë, unë jam e bindur se do ta votojmë pro këtë konventë, sepse të gjithëve na duhet të mbrojmë qytetarët tanë dhe t'i lejojmë ata të shikojnë se sa mirë punon qeveria, sa mirë punojmë edhe ne dhe si e kryejmë detyrën tonë. Faleminderit shumë!